



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 44, datë 08.02.2021

PËR
ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR.30, DATË
14.02.2019, “PËR RREGULLAT DHE PROCEDURËN E CAKTIMIT TË GJYQTARIT
PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJE GJYQËSORE TË VEÇANTË, NË NJË GJYKATË
TJETËR, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTRON FUNKSIONIN NË MËNYRË TË
PËRHERSHME”, NË LIDHJE ME NEVOJAT E GJYKATËS SË RRETHIT
GJYQËSOR KUKËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 4, pika 3, nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas njoftimit të marrë, më datë 08.02.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, për qenien e saj jashtë funksioni për shkak të diagnostikimit të gjyqtarëve të saj me Covid-19, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I :

1. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në kushtet kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, për një periudhë të papërcaktuar, duke filluar nga 09.02.2021, do të jetë jashtë funksioni, nevojat për caktim gjyqtari në çështje gjyqësore urgjente - për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset jo më vonë se 14 ditë nga regjistrimi në gjykatë¹ - deri në momentin e paraqitjes në detyrë të një prej gjyqtarëve të saj, do të trajtohen si më poshtë:
 - a) Për çështjet gjyqësore urgjente, në lëndë penale dhe civile, të cilat do të regjistrohen deri më datë 18.02.2021, Këshilli miraton menjëherë, mbi bazën e shortit, një listë gjyqtarësh nga gjykatat e tjera më të afërta të rretheve gjyqësore, për çdo periudhë pesëditore. Këshilli rishikon dhe përditëson listën e gjyqtarëve kur është e nevojshme.
 - b) Për çështjet gjyqësore sipas shkronjës “a” të këtij vendimi, në rastin kur gjyqtari i caktuar sipas rregullit të kësaj shkronje nuk është në detyrë gjatë periudhës pesëditore përkatëse ose në rastin kur për këtë gjyqtar konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje gjyqësore të veçanta, trupi gjykues formohet me gjyqtarin që gjendet i renditur më pas në listën e miratuar nga Këshilli. Gjyqtari i gjendur në situatën sipas kësaj shkronje, kur është e mundur, përmbush detyrën në periudhën pesëditore pasuese.
2. Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës merr masa për njoftimin në kohë të gjyqtarit të caktuar apo atij zëvendësues, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

¹ Shkronja “c”, neni 2, i Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Kukës dhe Tropojë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR